



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Nr. 902/1 Prot.  
Datë 09.11.2020



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 503/1 Prot.  
Datë 05.11.2020

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

## GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

### DHE

## DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

*«Për vijimin e përdorimit të ambienteve të vendosura në dispozicion pa kundërshpërblim pranë Gjykatës për t'u përdorur si Qendër e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore »*

\*\*Në vijim të objektit të kontratës lidhur mes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe «Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare ».

Sot, më datë \_\_\_\_\_ lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet  
Palëve :

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përfaqësuar nga Z.Zj. Arbër Çelca këtu e  
në vijim «Gjykata » ;

*Dhe*

Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, me adresë: Rr. Barrikadave, nd. Nr. 18, hyrja  
nr. 6, zyra nr. 10-3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së  
Ndhmës Juridike Falas z. *Ergys Qirici*, këtu e në vijim « *Drejtoria* ».

### HYRJE

*Duke qenë se* pjesë e projektit për “Zgjerimin e Shërbimeve të Ndhmës Juridike për  
Gratë dhe Burrat në Shqipëri” zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për  
Zhvillim për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me  
financim nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) është sigurimi i  
qëndrueshmërisë dhe garantimit të shërbimit të ndihmës juridike falas në Qendrat e  
Shërbimit të Ndhmës Juridike në Durrës; Fier; Lezhë; Dibër dhe Shkodër.

*Duke qenë se* “Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër” do të  
shërbejë për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore” për personat me të  
ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme si dhe kategoritë e veçanta të përfituesve të  
ndihmës juridike ku përfshihen:

- viktimat e dhunës në familje;
- viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve  
njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit  
penal;
- fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e  
kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me  
legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë  
edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e  
shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për  
shëndetin mendor;

- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- personat, ndaj të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- personat, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- personat, ndaj të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

*Duke qenë se “Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër” do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:*

- dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- dhënien e këshillimit;
- dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- përfaqësimin përpara organeve administrative; dhe
- dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

*Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur Marrëveshje.*

Neni 1

### **Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshje është vijimi i përdorimit të ambienteve të vendosura në dispozicion pa kundërshpërblim pranë Gjykatës për t'u përdorur si Qendër e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

Neni 2

### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në nenin 8 shkronja “gj” të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

### Neni 3

#### Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

**Palët e kësaj marrëveshje bashkëpunimi bien dakort si më poshtë vijon:**

- Gjykata** merr përsipër të garantojë mirëfunksionimin e qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore në ambientin e vendosur në dispozicion referuar marrëveshjes fillestare të bashkëpunimit, lidhur mes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Organizatës Jofitimprurëse, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare.  
**Gjykata** merr përsipër të ofrojë të gjitha lehtësitë lidhur me përdorimin e zyrës nga juristët e qendrës, duke u garantuar ndër të tjera :
  - Lehtësi në përdorimin e zyrës brenda orarit zyrtar dhe në respektim me rregulloren e Gjykatës ;
  - Lehtësi në përmbushjen e qëllimit të ofrimit të shërbimeve nga Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore ;
  - Të mbulojë pa shpenzime shtesë, furnizimin me internet dhe energji elektrike të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër.
- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas** merr përsipër që nëpërmjet **juristëve të qendrës të garantojë:**
  - Përdorimin e zyrës së vendosur në dispozicion nga gjykata vetëm për përmbushjen e qëllimit të qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore ;
  - Përdorimin e pajisjeve mbështetëse dhe shërbimeve të tjera të vëna në dispozicion në ambientin e përcaktuar nga Gjykata vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje dhe brenda kuadrit ligjor në fuqi ;
  - Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të vendosura në dispozicion aktualisht në ambientin e përcaktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje lidhet midis palëve, me afat, nga data 9 / 11 / 2020 deri në datën 9 / 11 / 2021, me të drejtë rinovimi për një afat tjetër të dakordësuar mes palëve.

### Neni 5

#### Personat e kontaktit

- Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike, ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:
  - Për Gjykatën: Z. Arbër Çela, Zv. Kryetar i Gjykatës

b) **Për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas:** Z. Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me email [ergys.qirici@drejtesia.gov.al](mailto:ergys.qirici@drejtesia.gov.al)

2. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) javë kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 6

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 7

### Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR GJYKATËN E RRETHIT  
GJYQËSOR SHKODËR  
Z.Zj. [Signature]**



**PËR DREJTORINË E NDIHMËS  
JURIDIKE FALAS  
Z. Ergys QIRICI  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

